



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Burimet të Informacionit në Mësimin e Gjuhës Së Huaj

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare
Viti / Semestri : Viti I , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave: ‘‘Mësuesi e Gjuhës Italiane ‘‘
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë të:Përftojë informacion/botëkuptim të përgjithshëm të proceseve, praktikave dhe efekteve të përfshirjes së burimeve të informacionit dhe teknologjive në procesin e mësimdhënies dhe kryesisht atë të mësimin të gjuhëve të huaja. hillojë pikëpamjeve pozitive përsa i përket përdorimit të teknologjive në mbështetje të të mësuarit gjatë gjithë jetës.Njohë vlerën pragmatike-komunikuese të burimeve dhe teknologjive të informacionit dhe përdorimet e tyre glotodidaktike Vlerësojë, qëmtojë materialeve të shumëllojshmë multimediale e të familjarizohet me mënyrat për të kërkuar burimet e duhura.

Objektiva te vecante lëndore:

Studenti përfton kompetenca specifike si:

- 1.Njohja dhe të praktikimi i përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit, programeve dhe platformave përkatëse në kuadër të mësimdhënies së gjuhës italiane si gjuhë e huaj.
- 2.Përftimi i njohurive dhe shprehive praktike lidhur me teknologjitë dhe burimet e informacionit dhe aplikimin e tyre në mësimdhënien e gjuhës italiane në shkollën e mesme në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës.
- 3.Aftësohet për vlerësimin përzgjedhjen dhe zhvillimin e materialeve multimediale si edhe didaktizimin e tyre për klasën e gjuhës së huaj.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Studenti do të jetë në gjendje të identifikojë dhe të përdorë në mënyrë kritike burimet digjitale dhe teknologjitë glotodidaktike (si softuerë didaktikë dhe mjete të internetit) në funksion të mësimdhënies së gjuhës italiane si gjuhë e huaj.
- 2.Studenti do të jetë i aftë të projektojë dhe të zbatojë aktivitete mësimore që integrojnë teknologjinë, duke përdorur materiale autentike audiovizive dhe adresat në internet për të ndërtuar mësim ndërveprues dhe të personalizuar.